

SHITBLERJET(SALES AND BUYES):

ADRESA E PRONARIT DHE FIRMA
(ADDRESS OF OWENER AND SIGNATURE):

ADRESA E POSEDUESIT DHE FIRMA
(ADDRESS OF POSSESSOR AND SIGNATURE):

PRONARI I RI (NEW OWNER):

SKEDUESI (COMPILER): MELIHA RAMALIU

DATA (DATE): 30/08/2006

KOMISIONI I VLERËSIMIT (COMMISSION OF ASSESSMENT):

- 1.
- 2.
- 3.

**DREJTOR
(DIRECTOR)**

Në bazë të Ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", objekti klasifikohet pasuri kulturore..
(According to Law 27/2018 "On Cultural Heritage and Museums", the object is cultural property.)

Lëvizja e objektit shoqërohet vetëm me lejen e Ministrisë së Kulturës. (The movement of the object should be executed only upon the permission of the Ministry of Culture)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIC OF ALBANIA

MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRY OF CULTURE

INSTITUTI KOMBËTAR I REGJISTRIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE
NATIONAL INSTITUTE OF CULTURAL HERITAGE REGISTRATION

Pronari (Owner) IF.K.ORTODOKSE
Poseduesi(Possessor) KOMUNITETET FETARE

ID: 0003

ID: 087

Drejtori i IKRTK(Director of NICHR)

Tel: +355(4) 22 269 03

Web: www.ikrtk.gov.al

Vula (Seal)

CERTIFIKATË OBJEKTI

NUMËR (NUMBER): 36943

VENDNDODHJA (LOCATION):

Shteti (State): Shqipëri Qarku (Region): Qark Rrethi (District): Qytet

Qytet/Fshat(City/Country): Tepelene Rruga (Street): -

FUSHA (DOMAIN): ARKITEKTURE

KATEGORIA (CATEGORY): Objekte Kult

TIPI (TYPE): Kishe

TITULLI (TITLE): Kisha e Profetit Ilia, Lekël, Tepelene

MATERIALI (MATERIAL):Gur

FOTOGRAFIA E OBJEKTIT 6 me 9 (cm)
(PHOTOGRAPHY OF OBJECT 6 by 9 cm)



Nr. i Regjistrimit (No. of Register):
Nr. i Inventarit (No. of Inventory):
KATALOGU (CATALOGUE)
"ONUFRË"

TË DHËNAT KRYESORE TË OBJEKTIT
MAJOR DATA OF THE OBJECT.

TEKNIKA (TECHNIQUE): E perzier

KULTURA (CULTURE): Shqiptare

PERIUDHA (PERIOD): Mesjetë e Vonë (-)

AUTORI (AUTHOR): ANONIM ANONIM

PËRMASAT(DIMENSIONS):

Gjatësia (Length): 14.5 Gjërësia (Width): 10.7 Lartësia (Height): -
Njësia (Unit): CENTIMETER

PESHA (WEIGHT):

VLERA (VALUE): 0 Lek

DORËZUESI (DELIVERER):

TË DHËNA TË TJERA (OTHER DATA):

Kartela u hartua nga M. Ramaliu me 30.08.2006

SHKALLA E DËMTIMIT (SCALE OF DAMAGE): 3

1. Shumë Mirë; ... 10. Shumë Keq (1. Very Good; ... 10. Very Bad)

ORIGJINALE/KOPJE (ORIGINAL/COPY): Origjinal

VEND ORIGJINA (ORIGIN PLACE):

VENDI I RUAJTJES (STORAGE LOCATION):

TRASHËGIMI (HERITAGE): Po

HISTORIKU: Ku dhe kur është zbuluar; kur ka marrë statusin e trashëgimisë kulturore.

(HISTORIC INFORMATION): Place and date of discovery, date of gaining the status of cultural heritage.

PËRSHKRIMI (DESCRIPTION):

Kisha është e tipit bazilikal trenefshe, me permasa 14,5x10,7 m. Dy rradhet e kolonave prej guri që ndajnë nefet, lidhen ndërmjet tyre dhe me muret perimetrale me harqe, duke krijuar një numer të madh berthamash, të mbuluara me kalota sferike, ndërsa berthamat e ambjentit të altarit janë të mbuluara me qemere cilindrike. Ambjenti i altarit përmban tre apsida të nxjerra jashtë. Naosi nuk përmban pikturë murale, ndërsa të gjitha pajisjet e saj të brendshme ishin zhdukur.

Ne anën perëndimore naosi lidhet me narteksin që ka sherbyer edhe si dhomë pagezimi. Në qoshin jugperëndimore të narteksit ngrihet kulla e kambanores.

Sipas gjurmëve, në anën veriore duhet të ketë qenë zhvilluar hajati.

Muratura dhe sistemi i mbulesës janë ndërtuar me gure jo të rregullt, të lidhur me llac gelqereje. Trajtimi i jashtëm është shumë i thjeshtë, ku mbizotëron masa e muratës së gurte dhe mungesa e elementeve dekorative. Të vetmet elemente që tentojnë të thyjnë këtë thjeshtësi janë apsidat në pamjen lindore, të cilat janë trajtuar me një varg harkdash të verbeta. Catia e gjere dyujese, e prere ne anen lindore, është mbuluar me tjegulla.

RESTAURIMI: Çdo lloj ndërhyrje; kush e ka bërë, si dhe rëlevimi topologjik i objekteve të paluajtshme.

(RESTORATION): Any kind of restoration work; the person(s) that have carried it out, as well as the topographic survey of immovable objects.

LËVIZJET E OBJEKTIT (MOVEMENTS OF OBJECT):

BIBLIOGRAFIA (BIBLIOGRAPHY):

Restaurimi i monumenteve të Kishës Ortodokse në Shqipëri.

Lekli eshte nje fshat malor rreth 800 m mbi nivelin e detit, 12 km larg Tepelenes, gjate rruges automobilistike qe e lidh me qytetin e Permetit.

Kisha ngrihet ne nje pozite zoteruese, prej nga hapet nje pamje e gjere mbi peizazhin rrethues. Per ndertimin e kishes ruhet ende gojedhana qe e lidh ate me emrin e Ali Pashe Tepelenes. Duke shkuar per ne Janine Pashai i jep urdher nje ushtari besnik te tij nga Lekli, Thanas Vajes, qe te ndertohej nje xhami mbi shkembin me te ekspozuar te fshatit. Ne kundershtim me urdherin e Pashait, ushtari con fjale ne fshat, qe ne ate vend te ndertohej nje kishë.

Ne kthim Pashai i habitur, pyet ushtarin pse nuk ishte zbatuar urdheri i tij dhe ushtari i pergjigjet se e ndertoi kete kishë per kaurret (te krishteret), sepse kishin kohe qe e kishin kerkuar. Ne ate kohe fshati kishte rreth 600 familje te krishtera.

Gjate periudhes se diktatures komuniste kisha ishte transformuar krejtesisht. Naosi ishte kthyer ne vatre kulture, narteksi ne furre buke, ndersa ne anen veriore ishte ndertuar nje shtese qe sherbente si ambulance fshati. Pervet kesaj braktisja e nderteses per nje kohe te gjate kishte krijuar probleme serioze per qendrushmerine statike te saj.